



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2454 Prot.
11

Patos më 25.08.2025.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 18.08.2025

I mbajtur sot më datë 18.08.2025 në orën 13:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë:

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltare:

1. Gani Ahmetaj
2. Suela Hoxha
3. Liljana Mesutaj
4. Vjollca Kasaj
5. Novrus Toska
6. Elmira Rama
7. Artan Velçani
8. Ertilla Myrtaj
9. Lori Musaj
10. Erald Çepele
11. Renaldo Shpata
12. Smerald Hazizaj
13. Armand Ahmetaj
14. Klaudio Alisinanaj
15. Elton Seraj

Takimi hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj.

Armand Ahmetaj – Përshëndetje të gjithëve!

Të nderuar këshilltarë!

Zhvillojmë mbledhjen e radhës e këshillit bashkiak.

Pjesëmarrja në mbledhjen e këshillit është 15 këshilltarë.

Kjo mbledhje ka si bazë ligjore nenin 53 pika 4 dhe 56 pika 2 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Para se të kalojmë në leximin e rendit të ditës doja të pyesja nëse keni ndonjë propozim për të shtuar apo për të hequr ndonjë pikë?

Vazhdojmë me leximin e rendit të ditës.

- 1- Miratimi i rendit të ditës.
- 2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 18.07.2025.
- 3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 18.07.2025.
- 4-Projekt-vendim "Për dhënien e mandatit të anëtarit të këshillit bashkiak znj, Adile Alushaj.
- 5-Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin korrik 2025".
- 6- Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin korrik 2025".
- 7- Projekt-vendim "Për miratimin e Planit të Arsimit Parauniversitar 2026-2028".
- 8- Projekt-vendim "Për miratimin e Planit Social 2025-2028".
- 9-Projekt-vendim "Për miratimin e Planit Vendor për Barazinë Gjinore 2026-2028 të bashkisë Patos".
- 10- Projekt-vendim "Për miratimin e dokumentit "Plani Vendor i Emergjencave Civile në territorin e bashkisë Patos 2025-2028".
- 11- Projekt-vendim "Për miratimin e Planit të mbarështimit të pyjeve "Ana e Lumit Seman".
- 12- Projekt-vendim "Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore, Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)".
- 13- Projekt-vendim "Për miratimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2025-2030".
- 14- Projekt-vendim "Për miratimin e Planit të Integritetit për periudhën 2025-2027", dhe shfuqëzimin e VKB nr. 30 datë 30.06.2025" Për miratimin e Planit të Integritetit për periudhën 2025-2027",

Armand Ahmetaj- Kush është dakord miratimin e rendit të ditës?

Miratohet me 16 vota pro pasi ka ardhur Albiona (Këshilltarja Albiona Lamaj) është shtuar kuorumi ligjor me 16 anëtar.

Miratohet me 16 vota pro abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE
Refaela Xeba



Lori Musaj
Smerda Hoxha
Vjollca Lani
Garafe 2025

KRYETAR
Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2451/Prot.
12

Patos më 25.08.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 18.08.2025 ora 13:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 18.07.2025.

Armand Ahmetaj – Kemi ndonje propozim për ndryshim apo korrigjim të procesverbalit ose ndonjë vërejtje?

Meqënëse skemi gjë tjetër deklarohet i ezauruar, i miratuar.

SEKRETARE
Refaela Xeba

Lori Musaj Huf.
Smered. Horaj

n/jollca Jaso
Jaso/12 2025

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2451 / 13 Prot.

Patos më, 25 08.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 18.08.2025 ora 13:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 18.07.2025

Armand Ahmetaj– Fjala për Refaelën

Refaela Xeba -Përshëndetje të gjithëve!

Në mbledhjen e datës 18.07.2025 u morën gjithsej 6 vendime nga nr. 38 deri në 43.

Vendimet janë zbardhur në afat dhe i janë përcjell drejtorive përkatëse për ekzekutim.

Nga këto vendime vetëm vendimi me nr. 40 dhe 42 i janë përcjell Prefekturës për verifikim të ligjshmërisë dhe na ka ardhur përgjigja në përputhje me ligjin.

Dhe vendimet e tjera i janë përcjell drejtorive përkatëse për ekzekutim.

Faleminderit!

SEKRETARE
Refaela Xeba

KRYETAR
Armand Ahmetaj

Lori Mosej

Smereta Hoxha

Yjellca Jashaj

18/08/2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1654 Prot.
6

Patos më 25 08.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 18.08.2025 ora 13:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e mandatit të anëtarit të këshillit bashkiak znj. Adile Alushaj.

Armand Ahmetaj- Ftoj kryetarin e komisionit të mandateve tna raportoj para këshillit!

Ertila Myrtaj- Kryetare e komisionit të mandateve –Përshëndetje të gjithëve! Komisioni i mandatve i përbërë nga Ertila Myrtaj Kryetare, Eduart Faslliaj zv kryetar, dhe Erald Çepele anëtar. Komisioni u mbledh në datën 13.08.2025 ora 11:00.

Ky komidion pasi shqyrtoj dokumentacionin, konstatoj se:

Dokumentacioni është i plote dhe perputhet me kerkesat ligjore;

Nuk ka pengesa ligjore per marrjen e mandatit

Subjekti ka respektuar afatet e dorezimit te vetedeklarimit;

Komisioni, me shumice votash, vendosi:

T'i propozoje Keshillit Bashkiak miratimin e mandatit te keshilltarit bashkiak për znj. Adile Alushaj.

Armand Ahmetaj- Jemi të hapur për votimin e raportit të komisionit të mandateve. Kush është dakord me raportin?

Miratohet me 16 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

Armand Ahmetaj- Ftoj znj. Adile Alushaj të bëj betimin “BETOHET NË NDERIN TIM SE DO TË KRYEJ ME NDËRGJEGJE DETYRËN E ANËTARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK DHE DO T’I BINDEM KUSHTETUTËS DHE LIGJEVE. BETOHET SE NË TË GJITHË VEPRIMTARINË TIME DO TË UDHËHIQEM NGA INTERESAT E SHETETASVE TË BASHKISË PATOS DHE DO TË PUNOJ ME NDERSHMËRI E PËRKUSHTIM PËR ZHVILLIMIN DHE RRIJTJEN E MIRËQENIES SË TYRE”.

Adile Alushaj- Betohet.

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj

Lori Musaj
Smerda
Vjollca
Lorisa
2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2456 Prot.

3

Patos më 25 08.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 18.08.2025 ora 13:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin korrik 2025”.

Elda Goxhaj Drejtore e Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit, Sektori i Shërbimit Social- Projekt-vendim nr. 46 datë 11.08.2025 “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin korrik 2025”.

Ekzekutivi i propozon këshillit bashkiak të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e buxhetit vendor për muajin Korrik 2025 gjithsej 17 familje me një fond prej 73,083 (shtatëdhjetë e tre mijë e tetëdhjetë e tre) lekë.

Familjet përfituese sipas listës dhe relacionit bashkëngjitur.

Klaudio Alisinanaj – Sekretar i komisionit të Ekonomisë – Po i referohem në cilësinë e sekretarit të komisionit meqë ishte në munges dhe kryetari dhe zv/kryetari. Komisioni i ekonomisë u mbledh ditën e premte dhe e miratoi me tre vota pro Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin korrik 2025”.

Prezent në sallë këshilltarja Klarida Semanjaku.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë pyetje? Njoftoj prezencën e 18 këshilltarëve.

Armand Ahmetaj –Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e pestë Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin korrik 2025”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord?

Miratohet me 18 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE
Refaela Xeba

Lori Musaj Hudh
Smered Hoxhaj
Vjollca Lasaj
Gazelle 2000

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2455/3 Prot.

Patos më 25.08.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 18.08.2025 ora 13:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin korrik 2025”.

Elda Goxhaj Drejtore e Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit, Sektori i Shërbimit Social-

Projekt-vendim nr. 45 datë 11.08.2025 “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin korrik 2025”.

Ekzekutivi i propozon këshillit bashkiak të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e buxhetit vendor për muajin Korrik 2025 gjithsej 18 familje me një fond prej 68,880 (gjashtë e tetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë.

Familjet përfituese sipas listës dhe relacionit bashkëngjitur.

Klaudio Alisinanaj – Sekretar i komisionit të Ekonomisë– Komisioni i ekonomisë ditën e premte dhe e diskutoi dhe këtë projektvendim dhe e miratoi me tre vota pro dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin korrik 2025”, sipas listës të propozuar nga ekzekutivi.

Armand Ahmetaj – Propozoj të kalojmë në votim e pikës gjashtë Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin korrik 2025”.

Kush është dakord?

Miratohet me 18 vota pro, ska kundër , abstenim ska.

SEKRETARE
Refaela Xeba

KRYETAR
Armand Ahmetaj

Lori Musaj Musaj
Smetod. Kozica
Ajlca Janaj
Gerasimozzi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 24501 / 13 Prot.

Patos më 25 08.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 18.08.2025 ora 13:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së shtatë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e Planit të Arsimit Parauniversitar 2026-2028”.

Armand Ahmetaj- Për këtë pikë është kryer dhe detyra ndaj ligjit për konsultimet publike. Është bërë dëgjesa në datën 05.08.2025.

Elda Goxhaj Drejtore e Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit,

Në përmbushje të detyrimeve ligjore për hartimin e planeve lokale dhe në kuadër të grantit të performancës dedikuar bashkive, bashkia Patos ka shprehur angazhimin për hartimin e Planit të Arsimit Parauniversitar 2026-2028. Ky plan strategjik u hartua përmes ekspertizës së Shoqatës Kombëtare të Bashkive dhe grupit të punës të ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 85, datë 23.05.2025 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit të arsimit parauniversitar”.

Për hartimin e këtij plani janë mbledhur të dhëna të detajuara për institucionet arsimore dhe janë përpunuar sipas formateve të kërkuara nga ekspertët. Grupi i punës ka rishikuar draft-dokumentin deri në draftimin përfundimtar të tij, i cili u konsultua më gjerë me grupet e interesit më datë 05.08.2025. Komentet dhe rekomandimet e dhëna janë dokumentuar në procesverbalin e takimit me nr. 2068/6 Prot., datë 07.08.2025, të cilat kanë konsistuar kryesisht në frekuentimin e institucioneve arsimore, shpërndarjes së tyre, transportit dhe infrastrukturës, të cilat janë reflektuar në dokumentin final.

Duke u mbështetur në vlerësime konkrete dhe në dialog të hapur me aktorët lokal, ky dokument pasqyron përpjekjet e bashkisë Patos për të ndërtuar një sistem arsimor që garanton zhvillim të hershëm cilësor, përfshirje të prindërve dhe komunitetit, si dhe mbështetje të vazhdueshme për institucionet dhe arsimtarët. Duke u mbështetur në rrjetin ekzistues të institucioneve arsimore, nga kopshtet deri në shkollat e mesme dhe duke adresuar sfidat aktuale të aksesit, infrastrukturës dhe përfshirjes gjinore, Bashkia Patos ka këto qëllime kryesore:

Qëllimi 1

Sigurimi i një mjedisi arsimor të sigurt, funksional dhe gjithëpërfshirës.

Të garantohen kushte të qëndrueshme infrastrukturore dhe funksionale për të gjitha institucionet arsimore në territorin e Bashkisë Patos, përmes mirëmbajtjes sistematike dhe investimeve të orientuara drejt standardeve bashkëkohore.

Qëllimi 2

Mbështetje për zhvillimin e plotë të fëmijëve përmes edukimit cilësor dhe përkujdesjes së integruar.

Të sigurohet zhvillimi emocional, social dhe kognitiv i çdo fëmije përmes shërbimeve edukative gjithëpërfshirëse dhe mbështetjes psiko-sociale në mjedise të sigurta dhe përkujdesëse.

Qëllimi 3

Zhvillimi i talenteve dhe ndjesisë së përkatësisë përmes veprimtarive jashtëmësimore

Të promovohet zhvillimi i potencialit krijues, fizik dhe social të fëmijëve përmes një kalendari të pasur aktivitetesh jashtëmësimore që nxisin shëndetin, bashkëpunimin dhe përfshirjen komunitare.

Zbatimi efektiv i Planit të Arsimit Parauniversitar kërkon një sistem të qartë dhe të qëndrueshëm monitorimi dhe vlerësimi, që siguron ndjekjen sistematike të progresit dhe ofron bazën për përmirësime të vazhdueshme. Ky sistem është i lidhur ngushtë me objektivat dhe aktivitetet e planit të veprimit dhe mbështetet në të dhëna të verifikueshme, pjesëmarrje të aktorëve dhe transparencë institucionale.

Indikatorët e performancës janë të përqendruar në vlerësimin e rezultateve të arritura në raport me objektivat strategjike. Ata janë të ndërlidhur me çdo kategori aktivitetesh në planin e veprimit dhe do të përdoren për matjen e progresit të përvitshëm.

Rishikimi dhe përshtatja e planit janë mekanizma thelbësorë për të siguruar vazhdimësinë, qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e ndërhyrjeve të planifikuara në fushën e arsimit në Bashkinë Patos. Këto procese shërbejnë për të ruajtur koherencën midis objektivave të planit, nevojave reale në terren dhe zhvillimeve të reja institucionale, ligjore apo sociale.

Për sa më sipër, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

Miratimin e Planit të Arsimit Parauniversitar 2026 – 2028 të Bashkisë Patos, pjesë përbërëse e këtij projektvendimi.

Suela Hoxha- Kryetare e komisionit të Arsimit, Shëndetësisë, Kulturës Rinisë dhe Sportet.
Përshëndetje- komisioni i Arsimit, Shëndetësisë, Kulturës, Rinisë dhe Sportet ka aprovuar me tre vota pro miratimin e projektvendimit për “Për miratimin e Planit të Arsimit Parauniversitar për vitin 2026-2028”. Ftojme të gjithë këshilltarët ta aprovjnë.

Armand Ahmetaj- Diskutimet janë të hapura

Armand Ahmetaj – Propozoj të kalojmë në votim e pikës shtatë Projekt-vendim “Për miratimin e Planit të Arsimit Parauniversitar 2026-2028”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord?

Miratohet me 18vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE

Refaela Xeba



KRYETAR

Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 24621 Prot.
13

Patos më 25.08.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 18.08.2025 ora 13:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e Planit Social 2025-2028”.

Ekzekutivi relaton materailin.

Elda Goxhaj Drejtore e Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit,

Në përmbushje të detyrimeve ligjore për hartimin e planeve lokale dhe në kuadër të grantit të performancës dedikuar bashkive, bashkia Patos ka shprehur angazhimin për hartimin e Planit Social 2025-2028. Ky plan strategjik u hartua nga grupi i punës i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit social 2025-2028”.

Ligji nr. 121/2016 “Mbi shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” ngarkon Bashkitë me detyrën e përgatitjes së Planeve Sociale bazuar në nevojat e identifikuar për shërbie të kujdesit shoqëror në territorin e tyre.

Bashkia Patos ka miratuar dy plane sociale: Planin Social 2020-2022 dhe Planin Social 2024-2027, të cilin grupi i punës është mbështetur për hartimin e Planit Social 2025-2028, drafti final i të cilit është konsultuar gjerësisht me grupet e interesit më datë 15.07.2025. Komentet dhe rekomandimet e dhëna janë dokumentuar në procesverbalin e takimit me nr. 1798/1 Prot., datë 16.07.2025, të cilat kanë konsistuar kryesisht në detajime shërbimeve specifike për kategori të caktuara shoqërore. Është rekomanduar ngritja e Njësisë së Vlerësimit dhe Referimit të Rasteve si dhe forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional për personat me probleme të shëndetit mendor. Identifikimi i nevojave për shërbime të reja të kujdesit shoqëror në territorin e Bashkisë Patos ka nxitur nevojën për të adresuar dhe priorizuar objektiva të tjera. Në zbatim edhe të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale dhe Dokumentit Politik për Moshimin dhe Planin e Veprimit 2025-2030, është synuar një qasje më gjithëpërfshirëse dhe e qëndrueshme e përmirësimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Vizioni i këtij plani është krijimi i mundësive për përdorimin e shërbimeve sociale cilësore për të gjithë qytetarët në nevojë në përputhje me nevojat e tyre në çdo njësi administrative të Bashkisë Patos.

Qëllimi strategjik:

Deri në vitin 2028, çdo person dhe familje në territorin e bashkisë Patos, kryesisht ata persona dhe familje të konsideruara në nevojë për shkak të përjashtimit shoqëror ose rrezikut të përjashtimit, do t’ju sigurohet mundësia e barabartë për të përfituar shërbime të përkujdesit shoqëror të cilësishme dhe në përputhje me nevojën e tyre, nga një sistem funksional dhe i integruar i shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në parimet e decentralizimit, deinstitutionalizimit dhe diversifikimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, në një mjedis të shëndetshëm, nxitës dhe mbështetës të institucioneve dhe komuniteteve, të gatshme për të realizuar përgjegjësitë e tyre për realizimin e të drejtave sociale.

Objektivat:

Objektiv 1 : Përmirësim, zgjerim shërbimesh dhe forcimi i sistemit ekzistues të integruar të shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashki i aftë të sigurojë shërbime të mbrojtjes, përkujdesit, integritetit dhe përfshirjes për të gjitha grupet në nevojë, të identifikuar dhe vlerësuara si të tilla, në përputhje me standartet kombëtare të shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

Objektiv 2: Krijimin e një ambienti të përshtatshëm që mbështet dhe ndihmon individët dhe grupet në nevojë kritike për t'u integruar në shoqëri, duke ruajtur dinjitetin njerëzor, pavarësisht nga gjendja e tyre ekonomike, shoqërore, shëndetësore apo autonomia e tyre funksionale, nëpërmjet politikave vendore efektive, në përputhje të plotë me nevojat dhe mundësitë e bashkisë.

Objektiv 3: Fuqizim të kapaciteteve institucionale, njerëzore, financiare, teknike të Bashkisë.

Plani i shërbimeve sociale të Bashkisë Patos bazohet në ofrimin e një pakete shërbimesh për të gjitha kategoritë e grupeve në nevojë, si dhe në filozofinë e ndërtimit të partneritetit midis aktorëve të ndryshëm, si institucionet e qeverisjes vendore dhe rajonale, organizatat ndërkombëtare, kombëtare dhe ato vendore, si dhe biznesin vendor si një mbështetës potencial në fuqizimin e shërbimeve sociale

Për sa më sipër, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

Miratimin e Planit Social 2025-2028 të Bashkisë Patos, pjesë përbërëse e këtij projektvendimi.

Vjollca Kasaj zv/kryetare e komisionit të Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale, Përsëritet të gjithëve! Ditën e premte është mbledhur komisioni i Barazisë Gjinore dhe Çështjeve Sociale dhe ka marrë në shqyrtim Projekt-vendim “Për miratimin e Planit Social 2026-2028”. Unë do të thosha që ky plan është miratuar me tre vota pro nga ana e komisionit por do të falenderoja grupin dhe komisionin që është marrë me hartimin e këtij plani për arsye se është një plan vizionar që ka objektiva të qarta për veprimtarinë e bashkisë që nga planifikimi i veprimtarive dhe deri tek zbatimi i tyre. Ftoj kolegët ta votojnë.

Albiona Lamaj - Vetëm një koment dhe unë do ta nis me përgëzime të bashkisë Patosit për hartimin e Planit Social ashtu siç unë e kam lexuar me vëmendje dhe e kam lexuar me shumë kujdes Planin Social sepse ashtu siç e tha edhe referuesja më përpara që ne po shkojmë drejt mëshimit dhe tani përkujdesja sociale është e rëndësishme dhe po bëhet e rëndësishme dhe ndryshe nga bashkitë e tjera që rreth vetes tyre mund të kemi dhe OJQ dhe gjërat tjera që mund të na vijnë në ndihmë ne jemi bashki e vogël dhe e dimë që e kemi këtë mungesë në territor prandaj e shikoj shumë të rëndësishme Planin Social dhe të bashkëpunimi ndërinstitucional që ato që nuk e kemi mundësinë nga nga OJQ ta kemi mundësinë në bashkëpunimin me njëri-tjetrin. Sygjerimi i vetëm do të ishte që ky Plan Social të shoqërohet edhe me ato mikroplanet e veprimit edhe me pjesë buxhetore që ti vijmë konkretisht në ndihmë qytetarëve, ne si Këshill Bashkiak do jemi të gatshëm që të miratojmë çdo lloj mikroplan veprimi që do ketë ky Plan Social.

Faleminderit!

Armand Ahmetaj –Kush është dakord me pikën e tetë Projekt-vendim “Për miratimin e Planit Social 2025-2028”.

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 18 vota pro.

SEKRETARE
Refaela Xeba



Lori Mucay
Smereta-Kozica
Vjollca Kasaj

KRYETAR
Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 24631 Prot.
3

Patos më 25.08.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 18.08.2025 ora 13:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së nëntë të rendit të ditës.

-Projekt-vendim "Për miratimin e Planit Vendor për Barazinë Gjinore 2026-2028 të bashkisë Patos".

Ekzekutivi relaton materailin.

Elda Goxhaj Drejtore e Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit,

Në përmbushje të detyrimeve ligjore për hartimin e planeve lokale dhe në kuadër të grantit të performancës dedikuar bashkive, bashkia Patos ka shprehur angazhimin për hartimin e Planit Vendor për Barazinë Gjinore 2026-2028. Ky plan strategjik u hartua përmes ekspertizës së Shoqatës Kombëtare të Bashkive dhe grupit të punës të ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 84, datë 23.05.2025 "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit vendor të veprimit për barazi gjinore".

Përgatitja e Planit Vendor për Barazinë Gjinore 2026-2028 është zhvilluar në bazë të një metodologjie të kombinuar, që ndërthuri analizën e thelluar të kontekstit lokal me orientimin nga kuadri ligjor dhe dokumentet strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare. Procesi ka qenë gjithëpërfshirës, i bazuar në të dhëna statistikore gjinore, në vlerësime institucionale dhe në praktikatat më të mira të planifikimit vendor të barazisë gjinore.

Grupi i punës ka rishikuar draft-dokumentin e dërguar nga ekspertët deri në draftimin përfundimtar të tij, i cili u konsultua më gjerë me grupet e interesit më datë 05.08.2025. Komentet dhe rekomandimet e dhëna janë dokumentuar në procesverbalin e takimit me nr. 2068/5 Prot., 06.08.2025. Për draft-dokumentin nuk pati rekomandime, por vetëm komente dhe pyetje të cilat patën përgjigje shteruese.

Për një periudhë trevjeçare, Bashkia synon të ndërtojë një realitet të prekshëm të barazisë gjinore, ku çdo vajzë dhe çdo djalë, çdo grua dhe çdo burrë, kanë mundësi të barabarta për të marrë pjesë dhe për të përfituar nga zhvillimi lokal. Përmes zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026-2028, do të konsolidohen strukturat institucionale, do të përmirësohet aksesueshmëria dhe cilësia e shërbimeve publike, do të zgjerohet pjesëmarrja e grave dhe vajzave në vendimmarrje, dhe do të ndërtohen komunitete më të sigurt, gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme ndaj nevojave të ndryshme gjinore në çdo cep të territorit bashkiak, orientuar këto në dy qëllime strategjike:

Qëllimi 1:

Forcimi i qeverisjes vendore përmes institucionalizimit të barazisë gjinore si parim themelor në çdo proces vendimmarrjeje, planifikimi apo raportimi publik

Kjo do të realizohet përmes Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm dhe transparent të raportimit publik mbi progresin për barazinë gjinore, duke përdorur të dhëna gjinore dhe platforma digjitale. Fuqizimi i mekanizmave institucionalë lokalë që merren me çështjet gjinore, përmes ngritjes së strukturave përfaqësuese, trajnimeve dhe rregulloreve funksionale dhe Nxitja dhe zgjerimi i pjesëmarrjes aktive të grave dhe vajzave në proceset vendimmarrëse dhe konsultimet me komunitetin.

Qëllimi Strategjik 2:

Ka të bëj me zhvillimi dhe ofrimi i shërbimeve publike gjithëpërfshirëse, të cilësisë së lartë dhe të ndjeshme ndaj gjinisë, që adresojnë nevojat konkrete të grave dhe burrave në të gjitha zonat e territorit të Bashkisë.

Garantimi i aksesit të barabartë dhe të balancuar territorialisht në shërbime publike të ndjeshme ndaj gjinisë, përmes strukturave vendore dhe mbështetjes ekonomike. Rritja e efektivitetit të qasjes shumë-sektoriale për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të dhunës me bazë gjinore. Transformimi i lagjeve në hapësira të sigurta dhe të aksesueshme për të gjitha grupet gjinore, përmes planifikimit urban të ndjeshëm dhe promovimi i përfshirjes së barabartë gjinore në jetën kulturore dhe sportive, përmes infrastrukturës, përmbajtjes dhe pjesëmarrjes së barabartë. Zbatimi i Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026-2028 do të shoqërohet nga një sistem i dedikuar monitorimi dhe raportimi, i cili siguron ndjekjen në kohë reale të progresit, evidentimin e sfidave dhe përmirësimin e vazhdueshëm të veprimeve të ndërmarra. Ky sistem do të bazohet në një qasje të kombinuar: institucionale, pjesëmarrëse dhe të bazuar në të dhëna.

Për sa më sipër, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë: Miratimin e Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026-2028 të Bashkisë Patos, pjesë përbërëse e këtij projektvendimi.

Vjollca Kasaj zv/kryetare e komisionit të Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale, Ditën e premte është mbledhur përsëri komisioni për barazinë gjinore dhe çështjes sociale dhe ka marrë në shqyrtim projektvendimin për miratimin e Planit për Barazinë Gjinore. Unë nuk do të shtoja të tjera gjëra për arsye sepse duke qenë pjesë edhe dëgjësave publike do them që të tre planet, si plani arsimit si plani i barazisë gjinore dhe i çështjeve sociale janë planet tepër të hollësishme të cilat kanë një informacion tepër domosdoshëm për gjithë qytetarët dhe jo vetëm kaq por edhe veprimtari të cilat ju urojmë grupit të punës që i ka hartuar edhe ti vëri në jetë në të mirë të qytetarëve.

Është miratuar me tre vota pro ky projektvendim dhe ftoi edhe kolegët ta miratojnë këtë projektvendim.

Armand Ahmetaj –Propozoj të kalojmë në votim të pikës së nëntë. Kush është dakord me pikën nëntë -Projekt-vendim “Për miratimin e Planit Vendor për Barazinë Gjinore 2026-2028 të bashkisë Patos”.

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 18 vota pro.

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2458 / 3 Prot.

Patos më 25.08.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 18.08.2025 ora 13:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dhjetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për miratimin e dokumentit "Plani Vendor i Emergjencave Civile në territorin e bashkisë Patos 2025-2028".

Armand Ahmetaj- Edhe për këtë projektvendim është hartuar një dëgjese publike conform ligjit për konsultimet publike. Ftoj ekzekutivin të paraqesë këshillit projektvendimin.

Arben Shpërdheja- Përgjegjës Sektori Emergjencave Civile Përhëndetje të gjithëve
Relacion për miratimin e dokumentit "Plani Vendor i Emergjencave Civile 2025-2028 në territorin e bashkisë Patos".

Hartimi i dokumentit "Plani Vendor i Emergjencave Civile 2025-2028", në territorin e Bashkisë Patos, sipas kërkesave të ligjit nr. 45/2019 datë 18.07.2019 "Për Mbrojtjen Civile".

Qëllimi:

Plani Vendor i Emergjencave Civile synon pikësëpari të mbrojë jetët njerëzore dhe të garantojë sigurinë dhe mirëqenien e banorëve gjatë Emergjencave Civile e fatkeqësive, duke minimizuar dëmtimin e pronës dhe infrastrukturës, trashëgimisë kulturore, gjësë së gjallë, komuniteteve dhe mjedisit. Këto objektiva janë në funksion të garantimit të vazhdimësisë duke ruajtur shërbimet dhe funksionet thelbësore gjatë dhe pas emergjencave apo fatkeqësive që mund të prekin bashkinë. PVEC i bashkisë Patos ka si objektiv madhor rritjen e aftësisë ripërtëritëse të komuniteteve vendore për të përballuar emergjencat dhe fatkeqësitë, si dhe garantimin e rimëkëmbjes së këtyre komuniteteve vendore pas fatkeqësive.

Bashkia Patos me qëllim hartimin e dokumentit "Plani Vendor i Emergjencave Civile" sipas kërkesave të ligjit nr. 45/2019 datë 18.07.2019 "Për Mbrojtjen Civile", miratoi Urdhrin nr. 12, me nr. 203 prot., datë 24.01.2024, ndryshuar me Urdhërin nr. 52, me nr. 203/2 prot., datë 13.03.2024 "Për krijimin dhe funksionimin e Grupit Teknik në nivel Bashkie për procesin e hartimit të Dokumenteve Strategjike për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe planit vendor, në nivel Bashkie", me grupin teknik të punës që ngarkohej që të punonte për hartimin e këtij dokumenti.

Në hartimin e këtij dokumenti, Grupi Teknik në nivel Bashkie për procesin e hartimit të Dokumenteve Strategjike për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe planin vendor në koordinim me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Prefektit të Qarkut, u mbështet nga kompania konsulente në kuadër të projektit RESEAL të UNDP.

1. Gjatë periudhës së punës së këtij Grupi Teknik:

U grumbullua gjithë informacioni i nevojshëm mbi risqet e mundshme nga permbytjet, termetet, zjarret në pyje, rrëshqitjet e tokës, ndotjet teknologjike dhe industriale dhe risqet biologjike që janë prezentë në territorin e Bashkisë Patos.

U bë studim i gjithë zonave me risk të shtuar të fatkeqësive duke pyetur komunitetin e zonave të banimit, bizneset dhe grupet e interesit.

U zhvilluan takime me persona kyç dhe u plotësuan pyetësorë për të marrë të dhënat referencë për hartimin e strategjisë.

Grupi i punës, i mbështetur nga kompania konsulente, hartoi dokumentin bazuar në të dhënat e mbledhura dhe konsultimet e kryera.

Gjatë periudhës së punës së këtij Grupi Teknik u bënë disa dëgjesa publike, veçanërisht për konsultimin e planit të veprimit me qëllim rregullimin e pasaktësive të mundshme dhe finalizimin e dokumentit. Në këto dëgjesa u ftuan të merrnin pjesë komuniteti lokal, bizneset dhe grupet e interesit, duke siguruar një përfshirje të plotë dhe të gjithanshme.

Dëgjesat publike dhe takimet me komunitetin lokal, bizneset dhe grupet e interesit ndihmuan në diskutimin dhe rafinimin e draftit përfundimtar. Këto konsultime siguruan identifikimin e sfidave kryesore dhe përfshirjen aktive të të gjithë aktorëve të rëndësishëm në procesin e hartimit të dokumentit.

Për të siguruar një qasje të koordinuar në nivel rajonal, u organizuan takime ndërmjet kryetarëve të bashkive të Qarkut Fier dhe Prefektit. Synimi ishte integrimi i Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë në politikat dhe planet rajonale, duke siguruar harmonizimin e strategjisë vendore me objektivat më të gjera të qarkut.

Me përfundimin e dëgjesës së fundit të zhvilluar 12.08.2025 u mbyll cikli i dëgjesave dhe Grupi Teknik finalizoi dokumentin në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 "Për Mbrojtjen Civile". Dokumenti reflekton kontributet e marra gjatë procesit të konsultimit dhe synon të përmirësojë aftësinë e bashkisë për të menaxhuar dhe zvogëluar risqet nga fatkeqësitë. Në këtë dëgjesë u morën sugjerime lidhur me afatin kohor të këtij plani ku u propozua që Plani i Emergjencave Civile të jetë me një afat 2025-2028, me të drejtë rishikimi edhe brenda këtij afati. Sipas procesverbalit të mbajtur me numër 2091/2 prot., datë 12.08.2025 u bën edhe ndryshimet e kërkuara.

Dokumenti do të shërbejë si një udhërrëfyes kyç për Planifikimin e Zhvillimit Urban. Ky integrim do të sigurojë që planifikimi urban dhe zhvillimi i bashkisë të marrë në konsideratë rreziqet natyrore dhe mjedisore, duke mbrojtur komunitetin dhe duke rritur qëndrueshmërinë e tij.

Ky dokument është themelor për përmirësimin e aftësisë së bashkisë për të menaxhuar risqet nga fatkeqësitë, por në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 45/2019, ai duhet të rishikohet dhe përmirësohet vazhdimisht, për t'u përshtatur me ndryshimet e mundshme në sfidat dhe rreziqet që mund të shfaqen.

Grupi Teknik vlerëson se dokumenti "Plani Vendor i Emergjencave Civile 2025-2028", është i përfunduar dhe përfaqëson një dokument i cili i paraqitet këshillit, ndaj mendojmë dhe kërkojmë miratimin

Faleminderit!

Armand Ahmetaj- Me shqyrtimin e këtij projektvendimi është ngarkuar komisioni i Shërbimeve Publike, Zhvillimit Urban, Ndërtimet dhe Pronat me Kryetar Artan Velçani. Të lutem Artan opinionin!

Artan Velçani- faleminderit kryetar komisioni përkatës u mblodh në datën pesëmbëdhjetë gusht dhe me shumicë përbërëse e miratoi këtë projektvendim por unë përfitoj nga rasti për të thënë dhe disa elementë të tjerë që lidhet jo vetëm me këto katër projektvendime ato të tre të tjera që vijnë më pas, sigurisht që ne jemi detyruar sepse është detyrimi ligjorë që të miratojnë plane të tilla.

Nga sa vura re nga 3 projektvendimet e mëparshme dhe nga fakti se si u konsultua dhe u gjykua në komisionin tonë projektvendimi përkatës unë gjykoj që kuadri ligjori i tij dokumenti ose këtyre dokumenteve është në përputhje me ligjin, janë përcaktuar shumë bukur dokumentat strategjike, vlerësuar risqet përkatëse, janë modeluar kapacitetet ku dua të falenderoj këtu grupet përkatëse të ngritura nga bashkia Patos si dhe ata që kanë asistuar organizata apo persona të ndryshëm në këto plane, janë përcaktuar saktësisht qëllimet objektivat dhe detyrimet përkatëse sigurisht që ngelet që të gjitha këto plane të kenë në vetvete ashtu siç e kanë në letra dinamizmin e tyre në mënyrë që ashtu siç edhe referuesi përkatës zoti Arben që në përputhje në kohë me afatet ato të kenë edhe vlerësimin përkatës. I bëj thirrje kolegëve që të miratojnë pikën 10.

Albiona Lamaj- Vetëm një koment Plani Vendor i Emergjencave Civile për bashkinë Patos, unë kam qenë edhe pjesë e grupit të interesit në momentin e hartimit planit dhe diskutimeve edhe për shkak të profesionit dhe pjesës tjetër bashkëpunimi ndërinstitucional edhe për shkak të faktit që tani ndodhemi në atë fazën ku territori është në emergjencë civile po jo në emergjencë tërësisht, shpesh herë emergjencë civile shkaktohen dhe nga dora e njeriut siç e kemi zjarret dhe që po e shikojmë që shpeshherë nga dora e njeriut do të thosha që plani emergjencave dhe ashtu si dhe në botën jashtë duhet parë i rëndësishëm jo vetëm momenti kur ndodh emergjencë apo duhet parë i rëndësishëm dhe në edukimin e komunitetit për të shmangur këto lloje emergjencë edhe përfshirjen e komunitetit si pjesë e planit të emergjencave unë e di që kjo është pikë e rëndësishme në këtë plan dhe e di që është futur dhe është hartuar dhe kjo pjesë dhe do doja shumë që të krijojë një vëmendje e rëndësishme në edukimin e komunitetit si për përballimin e emergjencave por ndonjëherë edhe për parandalimin e tyre, këtu e kam fjalën dhe me institucione se ne kemi diskutuar dhe e dimë që do të jetë kjo pjesa e edukimit ndërinstitucional dhe arsimor dhe pjesës tjetër por që shikoj të rëndësishme që duhet theksuar kjo gjë.

Armand Ahmetaj – Propozoj të kalojmë në votim e pikës së dhjetë Projekt-vendim “Për miratimin e dokumentit “Plani Vendor i Emergjencave Civile në territorin e bashkisë Patos 2025-2028”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 18 vota pro.

SEKRETARE
Refaela Xeba



Loni Musaj Musaj
Smerod Korica
Vjollca Karaj
Jasari

KRYETAR
Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2448/3 Prot.

Patos më 25.08.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 18.08.2025 ora 13:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së njëmbëdhjetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për miratimin e Planit të mbarështimit të pyjeve "Ana e Lumit Seman".

Donald Xhafa- Në mbështetje të nenit 8, nenit 9 pika 1/1, nenit 54 gërma "e" dhe "k", të nenit 27 të ligjit nr. 139 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjit nr. 44, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", ligjit nr. 9385 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", ligjit nr. 57, "Për pyjet", Dokumenti "Mbi Politikat e hartimit të planeve të mbarështimit për pyjet dhe kullotat i miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, VKM-së nr. 433, "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave i ndryshuar, kemi hartuar Planin e Mbarështimit të Pyjeve "Ana e Lumit Seman II", i cili kaloi dhe në konsultim publik me grupet e interesit më datë 16.07.2025.

Ky dokument paraqet një rëndësi të veçantë për pasurinë publike të pyjeve dhe kullotave, ku në mungesë të këtij dokumenti nuk mund të ndërhyhet në fondin pyjor e kullësor publik dhe për këtë arsye, jo pa qëllim, është cilësuar si "Kushtetuta e Pyjeve".

Mbarështimi i pyjeve ka të bëjë me planifikimin afatgjatë për pyjet publike dhe private, i cili kryhet në bazë të kriterëve të caktuara për grumbullimin e informacionit për situatën/gjendjen faktike dhe për përcaktimin e objektivave e masave të nevojshme, për sistemimin në përmbushjen ekologjike, ekonomike e sociale, duke zbatuar dhe zhvillimin e qëndrueshëm për nevojat administrative dhe përdoruesve të tyre.

"Plani i mbarështimit" është dokumenti bazë për mbarështimin e një ekonomie pyjore, që përmban analizën e gjendjes së pyjeve, përcakton objektivat që duhen realizuar në funksion të statusit që kanë, si dhe planifikon masat për trajtimin e tyre dhe ndërhyrjet për vitet e ardhshme. Me miratimin e ligjit të ri të pyjeve, bashkitë kanë përgjegjësi të plotë për menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullësor për ruajtjen, menaxhimin dhe qëndrueshmërinë e këtij fondi, por edhe për krijimin e të ardhurave, të cilat më tej përkthehen në investime.

Në Bashkinë Patos, asnjë nga ekonomitë pyjore nuk e kanë këtë dokument themeltar dhe të rëndësishëm duke u bërë pengesë serioze për vazhdimësinë e një menaxhimi të qëndrueshëm të kësaj pasurie publike.

Bashkia me fondet e veta bëri të mundur që të planifikojë hartimin e planit të mbarështimit të pyjeve në ekonominë pyjore Seman II, për 26.36 ha kryesisht, shkurre, trungishte, bimësi.

Rëndësia e një plani mbarështimi është se ka një impakt pozitiv dhe direkt në zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve.

Rrit të ardhurat e bashkisë

Plotëson nevojat për dru zjarri, si dhe lëndë ndërtimi.

Rigjeneron sipërfaqet pyjore të degraduara nga djegiet
Përmirëson strukturën e pyjeve
Rrit numrin e të punësuarëve.
Mbron tokat nga dukuria e erozionit.
Përsa më sipër i kërkojmë Këshillit të Bashkisë Patos:

Miratimin e Planit të Mbarështimit të Pyjeve “Ana e Lumit Seman II”, sipas dokumentacionit bashkëlidhur, si dhe në kuadër të kërkesës me nr. 1675 nga drejtoria së Zhvillimit të Taksave

Armand Ahmetaj- Me këtë pikë është ngarkuar komisioni i Bujqësisë.

Ermira Rama- ky projektvendim u shqyrtua nga komisioni nga tre anëtar të komisionit të bujqësisë dhe duke patur parasysh rëndësinë e pyjeve në tërësi të cilat u përsëritën dhe nga referuesi por edhe ate të zbutjes së efekteve të ngrohjes globale në veçanti është miratuar pro nga të tre antarët pjesëmarrës në datën 15.08.2025. Ftoj anëtarët ta miratojnë!

Kemi ndonjë pyetje? Atëherë propozoj të kalojmë në votim e pikës së njëmbëdhjetë Projektvendim “Për miratimin e Planit të mbarështimit të pyjeve “Ana e Lumit Seman”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 18 vota pro.

SEKRETARE
Refaela Xeba



Lori Musaj
Smerdet-Aoriza
Vjollca Lang

KRYETAR
Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 24581 / 3 Prot.

Patos më 25.08.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 18.08.2025 ora 13:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dymbëdhjetë të rendit të ditës.

12- Projekt-vendim "Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore, Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)".

Juela Shpata – Drejtore e Burimeve Njerëzore. - Pranë Bashkisë Patos është depozituar Marrëveshje (tip) "Për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis njësive të vetëqeverisjes vendore dhe këshillit të ministrave të Republikës së Shqipërisë për zhvillimin e kapaciteteve të vetëqeverisjes vendore të Shqipërisë, akademia e trajnimit të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Akt Themelimi "Akademia e trajnimit të njësive të vetëqeverisjes vendore nga Ministria përgjegjëse për çështjet vendore si institucioni ngarkuar për të negociuar dhe nënshkruar marrëveshjet me njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Kjo marrëveshje ka si qëllim krijimin e një personi juridik, subjekt i kompetencave të përbashkëta midis disa institucioneve, me synim rritjen dhe forcimin e vazhdueshëm dhe cilësor të kapaciteteve të të zgjedhurve vendorë, nëpunësve civil dhe punonjësve të institucioneve dhe ndërmarrjeve në varësi të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Për sa më sipër bazuar dhe në legjislacionin e shprehur në projektvendim kërkojmë nga ana juaj: Të miratojë marrëveshjen tip së bashku me aktin e themelimit të TALGA-së gjithashtu dhe autorizimin e Kryetarit të Bashkisë të nënshkruaj marrëveshjen ndërmjet ministrit përgjegjës për çështjet vendore, i autorizuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 405, datë 16.07.2025 si dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore dhe administrative dhe të nënshkruajë të gjitha dokumentet administrative për regjistrimin, ngritjen dhe funksionimin e TALGA-s, në përputhje me Statutin dhe Aktin e Themelimit, bashkëlidhur këtij projektvendimi. Efektet financiare që do të lindin nga kjo marrëveshje do të mbulohen nga zëri "Kuota Akademia e Pushtetit Vendor" i parashikuar në Buxhetin e vitit 2025.

Klaudio Alisinanaj- Kryetar i komisionit të Ligjeve – Komisioni i Ligjeve është mbledhur ditën e premte dhe ka arritur që ta miratoi me kater vota këtë projektvendim të paraqitur nga ekzekutivi që është "Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta. Faleminderit!

Armand Ahmetaj- Kemi ndonjë pyetje? Atëherë propozoj të kalojmë në votim e pikës së dymbëdhjetë Projekt-vendim "Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore, Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 18 vota pro.

SEKRETARE

Refaela Xeba



KRYETAR

Armand Ahmetaj

Lori Musaj
Smerodol Hoxha
Yolca Lasa
Josep Zora





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Ne 244 Prot.

Patos më 25.08.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 18.08.2025 ora 13:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së trembëdhjetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për miratimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2025-2030".

Armand Ahmetaj- Ftoj ekzekutivin

Cajup Refitaj Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit.

Hartimi i Planit Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve përfaqëson një detyrim ligjor dhe një angazhim strategjik të njësive të vetëqeverisjes vendore për të garantuar një mjedis të pastër dhe një zhvillim të qëndrueshëm për komunitetin. Ky plan mbështetet në kuadrin ligjor në fuqi, në veçanti në ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve", i ndryshuar, i cili përcakton detyrimin e bashkive për hartimin e planeve lokale në përputhje me prioritetet kombëtare dhe rajonale. Gjithashtu, ligji nr. 139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, i cili përcakton menaxhimin e mbetjeve si një ndër funksionet bazë dhe të deleguara të pushtetit vendor.

Ky plan synon të identifikojë situatën aktuale të menaxhimit të mbetjeve në territorin e bashkisë Patos, të përcaktojë objektiva të qarta dhe masa konkrete për reduktimin, riciklimin dhe trajtimin e mbetjeve në përputhje me parimet e ekonomisë qarkulluese dhe mbrojtjes së mjedisit.

Përgatitja dhe zbatimi i këtij dokumenti është thelbësor për përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe për përmbushjen e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e menaxhimit të mbetjeve.

Elementët kryesor të Planit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve janë:

1. Përshkrimi i gjëndjes ekzistuese.
2. Hartimi i objektivave SMART.
3. Hartimi i skenarëve për ofrimin e shërbimit.

Ky plan ka kaluar në konsultim publik me pjesëmarrjen e grupeve të interesit (banorë, kryetarë të fshatrave, përfaqësues të institucioneve dhe OJF) ku nuk ka patur propozime nga ana e tyre po vetëm pyetje.

Ngarkohet për menaxhimin e këtij plani Agjencia e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit.

Ju ftojme të miratoni këtë plan për peridhën 2025-2030.

Armand Ahmetaj- Për pikën 13 është ngarkuar komisioni shërbimi Shërbimeve Publike, Zhvillimi Urban, Ndërtimet dhe Pronat

Artan Velçani- Kryetar i komisionit të Shërbimeve Publike, Zhvillimi Urban, Ndërtimet dhe Pronat. Edhe ky projektvendim u mor në mbledhjen e komisionit përkatës që u zhvillua në datën 15 dhe siç e thamë më lart siç u shpreh dhe Çajupi si detyrime ligjore të detyrueshme ky u pranua edhe në komision dhe ju urojmë punë të mbarë bashkisë dhe grupit përkatës për zbatimin e këtij projektvendimi i cili është shumë sensibil për qytetarët e Patosit.

Armand Ahmetaj- Kemi ndonjë pyetje? Atëhere propozoj të kalojmë në votim e pikës së trembëdhjetë Projekt-vendim "Për miratimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2025-2030".

Armand Ahmetaj –Kush është dakord

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 18 vota pro.

SEKRETARE
Refaela Xeba



Lori Musaj
Smerold. Hoxhaj
Vjollca Xexaj

KRYETAR
Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2449/13 Prot.

Patos më 25.08.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 18.08.2025 ora 13:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërmbëdhjetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për miratimin e Planit të Integritetit për periudhën 2025-2027", dhe shfuqëzimin e VKB nr. 30 datë 30.06.2025" Për miratimin e Planit të Integritetit për periudhën 2025-2027",

Ernesta Hamiti – Përshëndetje! Me të këtij projektvendimi paraqesim për miratim Planin e Integritetit për periudhën 2025-2027 si dhe shfuqizimin e vendimit të këshillit bashkiak numër 30 datë 30 qershor 2025, siç besojë jeni në dijeni se në datën 30 qershor 2025 këshilli bashkiak miratoj Planin e Integritetit për periudhën 2025-2027. Për shkak se Plani Integritetit në zbatim të nenit 116 të Kushtetutës nuk plotëson kriteret për të quajtur akt normativ nuk u dërgua në Prefekturë për të marrë dhe mendimin e Prefektit. Pas miratimit të Planit të Integritetit në datën 11 korrik të vitit 2025 hyn në fuqi udhëzimi 1 i cili përcakton kriteret për grantin e performancës në të cilin thuhet edhe për Planin e Integritetit duhet të shprehet Prefekti.

Për këtë arsye për të marrë shprehjen e Prefektit mbi Planin e Integritetit ne kërkojmë nga ana juaj që të shfuqizohet vendimi i kaluar numër 30 i datës 30 qershor 2025 dhe të miratojmë planin për periudhën 25- 27 pa ndryshime në përmbajtje.

Faleminderit!

Klaudio Alisinanaj- Kryetar i komisionit të Ligjeve – Komisioni Ligjeve edhe për këtë projektvendim duke dëgjuar gjithë argumentet nga ekzekutivi për këto arsye që sapo i thanë tani vendosi ta miratoi me katër vota pro miratimin e Planit të Integritetit për periudhën 2025-2027 pa asnjë ndryshim duke shfuqizuar atë VKB nr. 30 datë 30.06.2025.

Faleminderit!

Armand Ahmetaj- Kemi ndonjë pyetje? Atëhere propozoj të kalojmë në votim e pikës së katërmbëdhjetë Projekt-vendim "Për miratimin e Planit të Integritetit për periudhën 2025-2027", dhe shfuqëzimin e VKB nr. 30 datë 30.06.2025" Për miratimin e Planit të Integritetit për periudhën 2025-2027".

Armand Ahmetaj –Kush është dakord

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 18 vota pro.

SEKRETARE
Refaela Xeba

Lori Masaj
Smereta Hoxha
Vjollca Liraj 18/08/2025

KRYETAR
Armand Ahmetaj